

FJALA E DEPUTETIT RAMADAN LIKAJ

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

U bënë dy ditë që po diskutohet për paketën fiskale të vitit 2022, për projektbuxhetin e shtetit dhe të qytetarëve. Fatmirësisht, mund të them se u bënë 3 javë që ne si deputetë po punojmë në mënyrë intensive për të zbërthyer, sidomos paketën fiskale, po ashtu edhe buxhetin e vitit 2022. Ne si deputetë kemi pasur fatin e mirë që gjatë kësaj periudhe të dëgjojmë të gjithë sipërmarrësit, të gjithë prodhuesit, që janë gjëja më e rëndësishme për ekonominë e një vendi, siç është Shqipëria. E vërteta është se unë nuk dëgjova në asnjë moment të vetëm nga sipërmarrësit ta përkrahin këtë paketë fiskale, përkundrazi, ata e ngritën zërin fort. Kurrë nuk mund të mendonin se në një situatë të tillë të krijohet kjo paketë fiskale. Në vend që të ketë ndihma për biznesin, në mënyrë të veçantë për biznesin prodhues, po ashtu edhe për fermerin, këtu ngrihen taksat çdo minutë. A ndodh në një vend demokratik të botës që të ngrihet një taksë në mes të vitit, sipas dëshirave të çdo pushtetari që e ka në dorë atë? Ne mendojmë që jo. Megjithatë, kjo situatë vazhdon të jetë tillë, kjo situatë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Me keqardhje mund të them sot se sipërmarrja, prodhuesit, që janë gjëja më e rëndësishme e një vendi, janë në një situatë shumë të vështirë. Unë do të doja të dëgjoja nga ata që ta përkrahnin këtë gjë. Përkundrazi, as majtas, as djathtas nuk u përmend një gjë e tillë, përkundrazi. Pse duhet qeveria të marrë sot nisma të kësaj natyre?

Unë do të ndalem në disa gjëra për sa i përket buxhetit. Fatkeqësisht, mund të them, e kam lexuar me shumë vëmendje, se nuk pashë për asnjë moment të vetëm një investim që mundet të jetë për zonën nga unë vij, madje, jo thjesht për zonën time, por në përgjithësi për qarkun e Shkodrës. Është për të ardhur keq që qarku i Shkodrës është bërë një gangrenë e jashtëzakonshme për këtë qeveri dhe kjo po vazhdon edhe në të ardhmen. Unë ndihem keq në një moment të caktuar që kolegët tanë të krahut të majtë, të Partisë Socialiste, nuk na përkrahin në nisma të tilla, për sa kohë gjatë fushatës elektorale kanë premtuar jashtëzakonisht shumë. Sot duhet të më mirëkuptojnë, por nuk ndihet zëri i tyre. Arsyet i dinë vetëm ata. Megjithatë, ne nuk duhet të ndalojmë për këtë pikë, por duhet të bëjmë maksimumin tonë për t'u thënë qytetarëve se çfarë është ky buxhet, kujt i përket ai dhe sa është i vlefshëm për ne. Mund të them që, në projektbuxhet, buxhet e quani ju, sepse e miratoni si të doni vetë, përmendet, flitet dhe ankoheni për unazën e Shkodrës, një unazë që përmendet për shumë e shumë vjet. Fatmirësisht, ne kemi shansin e mirë se jemi të asaj zone. Kanë nxjerrë disa makina dhe kanë bllokuar të dyja krahët. Ju nuk e dini se për çfarë unaze bëhet fjalë. Nëse kolegët e krahut të majtë na e thonë apo na e mësojnë këtë, absolutisht që kam kurajën e plotë të them ndjesë dhe tërhiqem. Përsëri kjo është një pjesë që ne do ta shikojmë në të ardhmen, pra sesi qeveria do të arrijë ta zbërthejë këtë buxhet, pse jo, do të jemi këtu bashkë me ju për të parë se cilat janë investimet për qarkun e Shkodrës për vitin 2022. Flitet shumë për bujqësinë. 127 milionë dollarë, buxheti më i madh! Thuhet që do të përfitojnë fermerët, prodhuesit, sipërmarrësit, deri në nivelin më të lartë, edhe eksportuesit.

Unë dua të kuptoj nga ju, për të qenë më i qartë, në fakt, jo unë, por fermerët, prodhuesit, se janë njerëzit më të rëndësishëm, se ku do të përfitojnë nga ky buxhet. E vërteta është se nuk mundet të gjesh asnjë pikë, asnjë resht të vetëm se ku mund të përfitojnë fermerët, lëre pastaj pjesën tjetër që

nuk diskutohet fare. Flitet shumë në krahun tjetër, edhe unë kam folur disa herë, e kam ngritur zërin në këtë parlament, për sa u përket disa investimeve që janë emergjente për zonën e Malësisë së Madhe. Shpresoj të ishte edhe kolegu im këtu i krahut të majtë, zoti Sterkaj, pse jo ta përkrahte këtë nismë, sepse ajo zonë i përket si atij, si mua, në mënyrë të veçantë të gjithë deputetëve të qarkut të Shkodrës, si majtas, pse jo edhe neve djathtas. Kur të vijë momenti i investimeve për qytetarët, besoj se ne nuk duhet të kemi ndasi. Unë nuk ndihem mirë si deputet i ri kur dëgjoj fjalë nga më të ndryshmet këtu, në mënyrë të veçantë nga deputetë të Partisë Socialiste që kanë shumë tagër, kanë shumë pushtet, pse jo kanë të drejtë ta përdorin foltoren e parlamentit sipas dëshirave të tyre.

Unë mendoj që ne të mos shpërqendrohemi, por le të jemi të fokusuar te ky buxhet realisht për atë që u vlen qytetarëve. Po përmend dhe po citoj diçka për sa i përket paketës fiskale, te gazi i lëngshëm, i cili rritet me 6 lekë. Imagjinoni sot dy pensionistë në shtëpi, me një pension minimal, me një rritje të tillë sot, u rritet kostoja mbi bazën e të ardhurave të atij pensioni që kanë, se nuk ka të ardhura të tjera, u rritet 70 %. Merreni me mend se çfarë do të ndodhë me ta. Sa ditë mund ta shtyjnë me ato lekë. Ndërsa ne vazhdojmë e bëjmë retorika mbi baza interesash. Pse deputetët e Partisë Socialiste nuk i përkrahin deputetët e Partisë Demokratike? Arsyeja është shumë e thjeshtë. Fatmirësisht, ne e kemi pasur fatin të drejtojmë edhe poste të tjera pushtetarësh, ndaj e dimë se si funksionojnë, por në një moment të caktuar, për interesat e qytetarëve, besoj se duhet të jemi bllok, duhet të jemi të bashkuar. Pse ky bashkim? Sepse të gjithë jemi të interesuar vetëm për qytetarët tanë. Të gjithë flasim në emër të qytetarëve, po kur vjen çasti, kjo nuk ndodh në realitet. Atëherë, lind pyetja: a duhet të vazhdojë të ekzistojë kjo ndasi kaq e madhe? Jo. Dihet se ne jemi në opozitë sot dhe e kuptojmë rolin tonë, e sigurisht që edhe ju duhet ta kuptoni rolin tuaj, por në një moment të caktuar, kur është fjala për buxhetin, që është buxheti i qytetarëve për dymbëdhjetë muaj, ne nuk shohim absolutisht një bashkëpunim nga ana juaj, nuk shohim frymë bashkëpunimi. Përkundrazi, mund të them se në komisionin ku unë marr pjesë kemi bërë dëgjesa të jashtëzakonshme, të gjithë ministrat kanë raportuar me radhë, e në fund asnjë nga kërkesat tona nuk është marrë fare parasysh. Kjo është për të ardhur keq. Prandaj, duke pasur edhe mirëkuptimin e kolegëve të mi të Partisë Demokratike, e sikur të kishim pasur edhe mirëkuptimin tuaj, pse jo, ky buxhet të shtyhet.

Të ulemi të gjithë së bashku, siç u shpreh një parafolës, i cili tha se: “Sot është shumë e rëndësishme, që ne të bëhemi bashkë për interesat e qytetarëve”. Absolutisht po. Unë jam një ndër ata që jam i gatshëm të ulemi dhe të rishikojmë, pse jo, investimet që janë shumë të rëndësishme për qytetarët. Të bëhemi unikë, dhe nesër, pasnesër apo sot një javë, pse jo, t’ju japim edhe votën për projektbuxhetin. Sepse, tekefundit, ne u shërbejmë qytetarëve. Ama kështu, duke bërë retorikë, ndërsa në anën tjetër buxheti miratohet, ngaqë ju keni numrat, ndërkohë që këtu flitet ndryshe, unë nuk besoj se mund të kemi mirëkuptim në këtë parlament. Duke mos e zgjatur shumë, sepse unë e kuptoj se si luhen të gjitha gjërat, më duhet të përmend ato që unë kam thënë para disa kohësh në këtë foltore, që qendra shëndetësore e Malësisë së Madhe (duhet të jetë ministrja, por ajo s’ndodhet përsëri këtu)... Faleminderit! Ne flasim këtu për buxhetin, por karriget janë bosh.

Pra, vini dorë në ndarjen e atij buxheti dhe hidhini sytë drejt asaj qendre shëndetësore. Është për të ardhur keq. Në seancat tjera do t’ju sjell me foto, do ta shihni shumë mirë se në çfarë gjendje është, në çfarë situatë është. Me keqardhje mund të them se dy metra është rruga për të hyrë te spitali. Imagjinoni atëherë se si është gjendja në atë spital. Një pikë tjetër për të cilën duhet të flas, ka të bëjë me fermerët, për të cilët flitet shumë. Thuhet se janë 127 milionë euro, më falni, dollarë. Lidhur me këtë, them: ku përfitojnë fermerët në mënyrë të drejtpërdrejtë? Përfitojnë drejtpërdrejt thjesht me këto skemat që kanë pasur deri sot? Në mënyrë selektive, duke bërë lista nëpër zyra të mbyllura dhe duke ndarë paratë me njëri-tjetrin? Absolutisht që kjo skemë duhet të bjerë njëherë e mirë. Kam

bindjen se e njëjta gjë do të ndodhë gjithkund, por këta kanë fatin e mirë, që i bëjnë listat vetë, selektimet i bëjnë vetë, e në fund përfiton pjesa e tyre. Ju faleminderit!